



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		25. 09 2023	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
02	060/04	48002	

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Drenasit

Opština Drenas –Municipality of Drenas

Kuvendi Komunal



P R O C E S V E R B A L

I DËGJIMIT BUXHETOR

Datë: 15.09.2023

Ora: 11:00

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Dëgjimi publik i thirrur nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal dhe Komiteti për Politikë dhe Financa, të ftuar ishin qytetaret e Komunës së Drenasit administrator të vendbanimeve, përfaqesues të lagjeve, të OJQ-ve, të rinjë, biznese, fermer, student dhe gjithë të interesuarit në dëgjim buxhetor për projekt buxhetin e Komunës së Drenasit për vitin 2024 dhe parashikimin për vitin 2025-2026, takimin e hapi Udhëheqësi i Zyrës për Informim, **Bekim Dobra**, dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari dhe të pranishëm ishin:

Ramiz Lladrovci	Kryetar i Komunës
Milaim Hajdari	Kryesues i Kuvendit të Komunës
Arben Shala	Nënkryetar i Komunës
Laureta Thaqi	Drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme
Petrit Gashi	Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Endrit Gllareva	Drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Publike
Agnesë Bucolli	Drejtoreshë e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
Nexhmedin Gruda	Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë,
Muhamet Gjoka	Drejtor për Drejtorinë për Arsimit
Petrit Sinani	Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit
Lumnije Krap	Drejtoreshë e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Anita Avdullahu	Drejtoreshë e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Shyqiri Bublaku	Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
Enkela Dema	Drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport

Temat të cilat u diskutuan në interes të përgjithshëm të Komunës së Drenasit:

Bekim Dobra, Udhëheqësi i Zyrës për Informim: I nderuari, Kryetar i Komunës së Drenasit, z. Ramiz Lladrovci, Kryesues i Kuvendit të Komunës, Milaim Hajdari, Nënkyetar, Arben Shala drejtor të drejtorive komunale, anëtar të Kuvendit të Komunës, administrator të fshatrave, përfaqësues të grave, student, pensionist, ju qytetarë.

Jemi mbledhur sot në këtë dëgjim buxhetor për të diskutuar planifikimin e buxhetit për vitin 2024 dhe projeksionet për vitet 2025-2026.

Kalendari i dëgjimeve buxhetore është përgatitur me kohë, sipas afateve ligjore dhe është publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës, në platformën e konsultimeve publike në rrjetin social të facebook-ut si dhe janë kontaktuar të gjitha grupet e nën përfaqësuarat për të qenë pjesë e këtij dëgjimi buxhetor. Komuna e Drenasit ka të hartuar edhe data bazën e të dhënave, ku është shfrytëzuar për të marrë pjesë të gjitha grupet e interesuara.

Komuna me kohë ka bërë njoftimin dhe ftesën. Që nga muaji Maj i këtij viti, pasi që kemi pranuar Qarkoren Buxhetore, kemi ftuar ekspertet, OJQ-të, Shoqërinë Civile dhe profesionistët për të kontribuar në hartimin e këtij dokumenti.

Ky dokument është përgatitur në bazë të Qarkores Buxhetore të lëshuar nga Ministria e Financave, e cila paraqet përmbledhjen e kërkesave fillestare të planifikimit e parashikimit për vitin 2024 dhe projeksionit të buxhetit për vitet 2025-2026.

Komuna e Drenasit shquhet për transparencë e llogaridhënie, ndaj me kohë këto dy dokumente, Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026 dhe draft-Listën e Investimeve kapitale i ka publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Ndjej për obligim të ju njoftoj me rregullat e takimit, që diskutimet për buxhet të jenë reciproke me qëllim që të behët një përmbledhje me interes për të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit. Pra, karakteri i këtij dëgjimi është që të jepni propozime, sugjerime dhe të diskutoni për planifikim të buxhetit për vitin e ardhshëm, por jo të jepni komente për projektet e këtij viti, ose viteve paraprake, sepse janë takime të tjera ato, kur qytetarët kanë mundësi të komentojnë projektet aktuale.

Para vetës keni dy materiale, draft-listën e investimeve kapitale si dhe informatën se si është planifikuar të adresohet buxheti komunal për vitet në vazhdim.

Të nderuar të pranishëm, fillimisht i jap fjalën kryetarit të Komunës, z. Ramiz Lladrovci.

Të nderuar të pranishëm tani fjala është për ju, por paraprakisht ju kisha lut që kur të merrni fjalën, të prezantoheni për arsye të regjistrimeve dhe mbajtjes së procesit të takimit.

Milaim Hajdari, Kryesuesi i Kuvendit Komunal: të nderuar ne jemi në muajin shtator dhe sot emi mbledhur sot ne këtë dëgjim buxhetor për të diskutuar planifikimin e buxhetit për vitin 2024 dhe projeksionet për vitet 2025-2026. Në bazë të ligjit i kemi mbajtur takimet me qytetar me të gjitha bashkësitë lokale të komunës tonë. Ne e kemi obligim ligjor si komitet për Politikë dhe Fincana që të mbajmë një takim me qytetar po përtej obligimit ligjor ne jemi këtu të diskutojmë që kërkesat primare të qytetareve dhe gjitha grupeve të interesit të inkorporohen në buxhetin e komunës për vitin 2024. I falënderoj të gjithë për pjesëmarrje. Ju ftoj për diskutim.

Habib Gashi, Administrator i fshatit Nekoc: Përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se përveç rrugëve asnjë projekt tjetër për fshatin Nekoc nuk janë të paraqitura në këtë buxhet për vitin 2024, kërkesa kemi paraqitur mjaftueshëm, por nuk po i shoh në këtë projekt buxhet. Në fshatin Nekoc po kemi probleme me kanalizim, me rrymë, trotuar, as çerdhen asnjë projekt që e kemi kërkuar nuk janë në këtë buxhet. Ne si fshat kërkojmë që të ndërtohet një çerdhe, dhe rregullimin e trotuarit.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Projektin për ndriçimi, trotuari dhe kanalizim e kemi në nivel komunal dhe e kemi cek që nuk ka më lagje pa drita përveç aty ku nuk ka shtylla të betonit, sa i përket ndërtimit të çerdhes ju kam njoftu edhe me herët që nuk mundemi ta bëjmë sepse nuk na lejohet numri i të punësuarve prandaj nuk mundemi me e bere dhe kërkesa juaj është legjitime mirëpo neve nuk na lejon ligji sepse nuk kemi të drejt me rrit numrin e te punësuarve në arsim.

Habib Gashi, Administrator i fshatit Nekoc: Ju njoftoj që shkolla Nekoc-it ka mbetur pa rrymë që nga dje deri nesër në mëngjes për arsye se KEDS nuk i rregullon telat, kërkoj që fshati Nekoc dhe Kishnarekë me kalu në sistemin e rrymës me Komunën e Drenasit dhe të tërhiqet me Komunën e Lipjanit.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Kam bërë kërkesa që me i kthij ato fshatra me Komunën e Drenasit dhe i plotëson nevojat trafaja, pra jemi në proces që t'i kthejmë edhe ato fshatra mirëpo nuk varet nga ne pa u bere elektrofikimi i ri krejt që me pas mundësi me i lodh me komunën tonë.

Samedin Kiqina, Administrator i fshatit Baicë: Kërkoj që kanalizimi i ujërave të zeza të rregullohet, ndriçimi publik, dhe kërkesat për emërtime të rrugëve a po kryhen këtë vit, kërkoj ndërtimin e një fushe të sportit, një rrugë në fshatin tonë është shumë e ngushtë kërkoj zgjerimin e rrugës sepse po ka probleme shumë ku dhe po ndodhin aksidente në atë rrugë.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Sa i përket kanalizimeve të ujërave të zeza nuk ka fshat në Komunën e Drenasit që kemi punuar me shumë se ne fshatin Baicë, jemi para përfundimit, sa i përket dritave ne kemi bërë kërkesa në KEDS që me i vendos orët matëse në fshatin tuaj.

Florentina Elezi-Veliu, Asambliste: Ne si LVV kemi bërë një propozim për subvencionim për lehonat në Komunën e Drenasit, dhe kërkesa tjetër është për me i subvencionua familjet me kushte

jo të mira ekonomike që i dërgojnë fëmijët në kopshte private në këtë formë me ia lehtësua grave në tregun e punës.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Sa i përket subvencionim të lehonave kur një institucion tjetër subvencionon lehonat nuk munden me pas subvencionim të dytë nga i njëjti buxhet i shtetit, janë kërkesa të nevojshme dhe të arsyeshme mirëpo qeveria e ka marr përgjegjësi këtë çështje.

Zekë Kluna, Administrator i fshatit Poklek i Vjetër: Në Poklek të Vjetër kërkojmë furnizimin me ujë të pijes, ndriçimin i rrugëve në Poklek dhe Vasilevë, firmat që i kanë kryer disa punime në rrugë gypat janë prish tek shkolla në Poklek dhe tek lumi "Drenica". Një gropë septike me e mbyll kërkoj me marrë masa sa i përket kësaj çështje. Dhe kërkesë tjetër rregullimi i një parku të vogël tek ujti i thartë. Ndërtimi i një fushe sportive tek Banosat e reja në Poklek të Ri.

Drejtoria e Infrastrukturës Publike : Ndriçimi publike do te vendoset në të gjitha fshatrat, ne fshatin Poklek i Ri ka perfudnuar ne 90% ne fshatin Poklek i Vjetere kanë mbetur disa rrugica të vogla qe brenda vitit 2024 di të përfundohen si dhe ne fshatin Vasilevë do ketë investime te reja në ndriqim publik. Demolimi i gropës septike do të kryhet brenda viti 2024 si proces i punimeve duhet te parashihet në projektin e viti 2024.

Habib Mulaj, qytetar nga Drenasi: Furnizimi me ujë të pijes në qendër. Çështje tjetër parkingu në qendër ku është planifikua sheshi, kërkoj me u integrua edhe një parking.

Drejtoria e Infrastrukturës Publike : Ujësijellsi Rajonal Prishtina –Njesia në Drenas është ajo që menaxhon me ujë të pijes dhe e cila grumbullon taksat nga ky shërbim. Komuna ka krijuar hapësira të mjaftushme për vend parkingje brenda qyteti.

Sabrije Berisha, banore e fshatit Shtuticë: Kërkoj që në lagjen e tyre të asfaltohet rruga.

Drejtoria e Infrastrukturës Publike : Gjatë viti 2024-2025 janë planifikuar të përfundohen të gjitha rrugica aty ku pronësia e rrugës është publike.

Meqë nuk pati diskutime tjera, kryesuesi e konsideroj të mbyllur dëgjimin buxhetor. Dëgjimi buxhetor përfundoj rreth orës 12:00 min.

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Milaim Hajdari



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/0458002 dt. 25. 09 2023

Dëgjimi buxhetor i mbajtur me datë 15.09.2023 (e premte) duke filluar nga ora 11:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Emri Mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
Habib Gashi	NEKOC	Gashi
Zefë Daka	Poklek	Daka
FATUNDA ZYMBERI	PORUCK IRI	Zymeri
ALBUENA SALIUKU	GRADICE	Saliku
Edmond Busha	Drenas	Busha
EGZON GORRI	DRENAS	Gorri
ESHREF	NIKA	Eshref
AVDYL MZIU	KOMORAN	Mziu
Anton Haxhiu	Shtruballorë	Haxhiu
Albenita Berisha	Tërstenik	Berisha
HENTOR ZEKA	NEKOC	Zeka
Florentina Elezi	Drenas	Elezi
GRANT ELSHALI	GILBAR	Elshali
Floriana Hasi	Gilloq	Hasi
Lajla Basha	Shtruballorë	Basha
Abdi Veli	Korrotre e Ulte	Veli
Djellor Berisha	Llapushnik	Berisha
SHKURRI MEHMETI	ABRI E ERDAR	Meheri
Skender Berisha	Monas	Berisha
Arif Gashi	Llapushnik	Gashi
ADELINË DERVISHI	GIKATUVËDËTËR	Dervishi
DELETA SYLKE	ABRI E ERDAR	Sylke
SHUKRIE AZIZI	KORROTRE E ULTE	Azizi
Enona Gashi	Dritan	Gashi
HABIB MULLA	DRENAS	Mulla
Agim Karim	Drenas	Karim

